



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

Viti shkollor 2012/2013


TESTI 2

GJUHË SHQIPE

UDHËZIM PËR PUNË

- Testin të cilin duhet ta plotësosh i ka 20 detyra, kurse për zgjidhjen e tyre janë paraparë 120 minuta.
- Lexo me kujdes çdo detyrë, në fillim dhe mendo për këtë se çfarë kërkohet në të. Gjej mënyrën e zgjidhjes së saj (duke rrethuar, lidhur, nënvizuara, përshkruar etj.).
- Në detyrat, në të cilat nga ti kërkohet të shkruash diçka, gjithmonë përdor emërtimet e plota; shkurtesat nuk janë të lejuara (psh. Duhet të shkruhet emër e jo em., kallëzore e jo kall. apo diçka ngjashëm).
- Testin duhet ta plotësosh me **stilolaps**. Gjatë punës mund të përdorësh lapsin grafit dhe gomën. Para se të dorëzosh testin, verifiko përgjigjet tuaja edhe njëherë, e pastaj të gjitha përgjigjet shkruaji me stilolaps. Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps grafit nuk pranohet, por as përgjigjja të cilës i është hequr vizë dhe e cila është korrigjuar me laps kimik.
- Në katrorin, i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës, mos shkruaj asgjë. Kjo është hapsira ku kontrolluesi shkruan numrin e poenëve. Në këtë hapsirë dhe në faqen e fundit gjithashtu mos shkruaj asgjë.
- Nëse zgjidhjen e detyrave e mbaron më herët, dorëzo testin dhe ngadalë largohu pa i penguar të tjerët.

Të dëshirojmë sukses në provim!



1. Para një viti Diellza shkoi me pushime në Durrës. Sa bukur ishte atje! Uji ishte i pastër dhe deti shumë i thellë. Diellza notonte me krahëza.

Këtë vit Diellza do të shkojë me pushime në Sarandë. Ajo shpreson se sivjet do të notojë pa krahëza. Babi i ka premtuar se do ta ndihmojë të mësojë notin.

Asaj i pëlqen shumë të notojë në det

Teksti i dhënë ka:

- a) 2 paragrafë
- b) 3 paragrafë
- c) 4 paragrafë

Qarko përgjigjen e saktë.

2. Nëse teksti është administrativ, pas tij ne vije shkruaj "A", nëse është publicistik, shkruaj "P", e nëse është shkencor, shkruaj "SH":

a) Paraqitja për sezonin e sivjetme të kampioneve tek ne dhe ne bote ka filluar në fillim të marsit dhe deri me tani, siç mësojmë nga organizuesit e shoqatës "Hulumtuesit e rinj", janë paraqitur 430 vullnetare të rinj. Janë edhe 1.700 vende të lira, dhe paraqitja mund të behet derisa të plotësohen të gjitha kampet. _____

b) Fjalët *u, do, të, me, për, pa, duke, me* përfshihen të pjesëzat që shërbejnë për të ndërtuar forma gramatikore foljore dhe shkallet e mbiemrave e të ndajfoljeve. Kur përdoren një varg kallëzuesish homogjene, pjesëzat që shërbejnë për të ndërtuar forma gramatikore të foljeve përsëriten para çdo kallëzuesi:

Pjesëza *të* para lidhore shkruhet gjithmonë kur përsëritet trajta foljore:

Unë mendoj të takohemi e të bisedojmë të gjithë bashkë sa më shpejt.

c) Mbrojtësi i qytetareve është organ i pavarur shtetëror i cili i mbron të drejtat e qytetareve dhe e kontrollon punën e organeve të administratës shtetërore, organit kompetent për mbrojtjen juridike të të drejtave pronësore dhe interesave të shtetit, si edhe organeve dhe organizatave tjera, ndërmarrjeve dhe institucioneve të cilave u besohen autorizimet publike. _____

3. Doli nga shtypi libri "Dasma shqiptare në Preshevë dhe rrethinë dikur dhe sot" i cili u botua në kuadër të Shoqatës së Trashëgimisë dhe të Krijimtarisë Kulturore, me seli në Preshevë.

Ky libër është i veçantë, sepse në të janë të prezantuara kumtesat shkencore të mbajtura në Tribunën e organizuar vitin e kaluar me temë të njejtë sikur kjo e paraqitur më lart.

Ky është edicioni i dytë i botimit të këtij lloji, sepse para këtij libri është botuar edhe një libër me kumtesa të tjera dhe me tematikë tjetër.

Qarko përgjigjen e saktë.

Teksti i dhënë është tekst:

- a) Tregim;
- b) Prezantim;
- c) Reklamë;
- d) Debat.

4. 1.

Ndërmarrja për tregti të jashtme dhe të brendshme “Qeramika” SHPK, ju ofron shërbime cilësore në rregullimin dhe zbukurimin e shtëpisë tuaj. Ofrojmë këto shërbime: bëjmë veshje me mermer dhe granit: të shkallëve, ballkoneve, oxhaqeve, kuzhinave, tavolinave, fontanave, Lapidarëve etj.

Në ndërmarrjen “Qeramika” SHPK, ju mund të gjeni shumë lloje të Mermerit dhe Granitit.

2.

Me 1 shkurt 1992 Amerika dhe Rusia i dhëne fund luftës se ftohte në një deklaratë të përbashkët të presidentit rus Boris Jelcin dhe ai amerikan Xhorxh Bush.

Lexo tekstet e dhëna dhe trego cilit lloj të teksteve u takojnë. Qarko përgjigjen e saktë.

Teksti 1 është:

- a) Reklamë;
- b) Lajm;
- c) Analizë.

Teksti 2 është:

- a) Përshkrim;
- b) Informatë;
- c) Prezantim.

5. Ky është një futbollist. Ka trup të fuqishëm dhe të gjatë. Ka mustaqe të zeza dhe flokë të zinj. Është veshur me bluzë të kuqe me vija të bardha. Është i shkathët dhe plot energji, i qeshur kureshtar dhe luan shumë bukur. Gjatë lojës do të jetë në qendër të vëmendjes. Tregohet shumë i sigurt në lojë. Është optimist dhe mirënjohës.

Lexo tekstin e dhënë dhe veço fjalët kyçe: _____

_____.

6. I. Nesër do të vish me ne? - pyeti Mirela.

- Nuk jua jap fjalën, - u thashë unë.

II. Kur do të shkosh në teatër? pyeti Ela.

- Besoj se do të iki nesër, i thashë unë. Po të mos më dalë ndonjë punë.

Lexo shembujt e dhënë. Në cilin shembull shenjat e pikësimit janë vendosur si duhet në:

- a) në dialogun I
- b) në dialogun II

7. **Fjalja nxitëse** “*Të kujdesemi për gjelbërimin e mjedisit në shkollë.*” **kumton:**

- a) ftesë;
- b) propozim;
- c) urdhër;
- d) porosi

8. Shkruaj shumësin e pashquar për emrat e poshtëshënuar:

babai/djali _____

9. Fjalët e dhëna shkruani në gjuhën letrare:

Tlyen _____; Skile _____; Tamël _____;

Kamba _____; Syni _____;

10. 1. Lexo fjalitë e dhëna dhe nënvizo cilat fjalë janë shkruar në gjuhë dialektore. Në vizat përkatëse shkruaji ato.

a) Aktyvitet jopolitik. _____/_____.

b) Punojka në arsim. _____/_____.

c) Ambijent i ndotur. _____/_____.

d) Shkëmbyemje zjarri. _____/_____.

2. Nënvido fjalët të cilat janë shkruar sipas rregullave drejshkrimore dhe në gjuhën letrare. Në vizat në vazhdim shkruaji ato.

11. Ndaj në rrokje në fund të rreshtit (në disa mënyra) fjalën fëmijët.

a) _____,

b) _____,

c) _____.

12. Lexo me kujdes këto fjalë:

Drej'tori (dre-j-tor-i) drejtori-a.

‘bari (bar-i) - ba’ri (bari-u)

A kanë kuptim të njëjtë apo të ndryshëm këto fjalë homonime dhe kush e luan rolin kryesore në kuptimin e tyre?

13. Shenjën e pikësimit, pikëçuditje në fund e marrin këto fjali:

- a) dëftore-thirrmore
- b) nxitëse
- c) nxitëse – thirrmore
- d) pyetëse – thirrmore
- e) dëftore

Qarko përgjigjen e saktë.

14. Përcaktoni klasën e fjalëve të nënvizuara në fjalitë e mëposhtme.

1.

- a) Aty, zinin e gjuanim **me** gurë. _____
- b) Më shtrëngoi **fort** pas vetes. _____
- c) Amiri na kishte shpikur **edhe** një lojë.

2.

Shkruani përbërësit e fjalës udhëtarët.

- a) rrënja: _____
- b) prapashtesa: _____
- c) mbaresa: _____

15. Përcaktoni trajtën dhe rasën e emrit të nënvizuar në fjalinë e mëposhtme.

Kur u ktheva, ai nuk ishte më te gardhi duke më pritur, si gjithmonë.

- a) Trajta: _____;
- b) Rasa: _____;
- c) Numri _____.

16. ËNDRRA E SKËNDERBEUT

Skënderbeu kishte qenë duke fjetur në mal. E pa një ëndërr, sikur dikush po e thërriste: “O Skënderbe! Zgjohu nga gjumi dhe shiko diçka në lis” !. Skënderbeut i del gjumi në agun e mëngjesit dhe po shikon qiellin të kuq si gjaku, ende pa lindur dielli. Duke parë ashtu, e pa mbi lis shqiponjën me krahët hapur. Skënderbeu mori lapsin dhe një letër, e vizatoi qiellin e kuq dhe shqiponjën e zezë – e kështu doli flamuri kuq e zi.

E popullit

Lexo pjesën e dhënë dhe qarko përgjigjen e saktë.

Kjo pjesë është një krijim popullor:

- a) tregim;
- b) përrallë;
- c) fabul;
- d) legjendë.

17. Lidh titujt e veprave letrare me ane të vizave me emrat e autoreve

- a) Rrahman Dedaj _____ Aventurat e Çipolinos
 b) Ismail Kadare _____ Sarajet e bardha
 c) Vehbi Kikaj _____ Bagëti e bujqësi
 d) Xhani Rodari _____ Kështjella
 e) Naim Frasheri _____ Zogu dhe kulla

18. Përballë titujve të krijimeve të mëposhtme shëno llojin letrar përkatës.

- a) Kenga e Beratit _____
 b) Ali Pashe Tepelena _____
 c) Gjonmadhe e Gjatollinj _____
 d) Arnaut Osmani _____
 e) Dedali dhe Ikari _____
 f) Liqeni i luleve _____

19. Rretho alternativën e saktë. Krijimet lirike janë:

- a) poezi të shkurtra
 b) poema
 c) balada
 d) fabula në vargje

20. Rretho alternativat e sakta.

1. Në gjininë lirike autori:

- a) rrëfen ngjarjen (vetë ose nëpërmjet personazheve)
 b) rrëfen ndjenjat dhe mendimet e veta
 c) rrëfen nëpërmjet veprimeve të personazheve
 d) rrëfen ngjarje dhe shpreh ndjenjat dhe mendimet e vet.

2. Në gjininë epike autori:

- a) rrëfen ngjarjen (vetë ose nëpërmjet personazheve)
 b) rrëfen ndjenjat dhe mendimet e veta
 c) rrëfen nëpërmjet veprimeve të personazheve
 d) rrëfen ngjarje dhe shpreh ndjenjat dhe mendimet e vet.

Rezultati në testin e gjuhës shqipe

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!
Këtë faqe e plotëson Komisioni!

Numri i përgjithshëm i pikave

		,	
--	--	---	--

Komisioni:

- _____
- _____
- _____
- _____

Numri i pikave për secilën detyrë.

Numri i detyrës	E pplotësuar	0 pika	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Shkruaj ✕ në vendin përkatës.

Numri i identifikimit (Shifra e nxënësit)	
Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	